

DEKRET
Nr.1786, datë 30.4.1997

PËR AUTORIZIMIN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MUAJIN MAJ
1997

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 20 të dekretit nr.266, datë 22.7.1992 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", miratuar me ndryshime me ligjin nr.7616, datë 30.9.1992, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

Neni 1

Autorizohet kryerja e shpenzimeve për muajin 1997 si vijon:

Shpenzime për paga	1890 milionë lekë
Shpenzime për kontributin e sigurimeve shoqërore	505 milionë lekë
Shpenzime për papunësinë	200 milionë lekë
Shpenzime për ndihmën ekonomike	330 milionë lekë
Transferime për sigurimet shoqërore	750 milionë lekë
Transferime për sigurimet shëndetësore	70 milionë lekë
Shpenzime operative	1012 milionë lekë
Shpenzime për interesa	550 milionë lekë
Shpenzime për investime	500 milionë lekë
Shpenzime për subvencione	80 milionë lekë
Totali:	5887 milionë lekë

Neni 2

Shpenzimet për financimet e huaja të vazhdojnë sipas marrëveshjeve.

Neni 3

Buxheti i shpenzimeve korente për çdo ministri dhe institucion qendror paraqitet bashkëngjitur në tabelën nr.1.

Neni 4

Shpenzimet për investime në masën 500 milionë lekë do të përdoren për përballimin e kostos lokale dhe TVSH-së, për projektet e huaja dhe për përballimin e shpenzimeve për rehabilitimet më emergjente të institucioneve shtetërore. Ngarkohen Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj dhe Ministria e Financave për përdorimin e këtij fondi.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.8212, datë 7.5.1997 të Kuvendit Popullor

